

## **PENSIONIMI**

### **KUSH JANË SHTYLLAT KRYESORE TË PENSIONIMIT NË ZVICËR?**

Sistemi i pensionimit në Zvicër mbështetet në tri shtylla kryesore, edhe ate

#### **Shtylla e parë: sigurimi bazik i pleqësisë (AVS)**

Kuotizimet paguhen si nga punëdhënësi ashtu edhe nga i punësuarit. Shuma e kuotizimeve tërhiqet drejtpërdrejt prej rrogës mujore. Kuotizimet aktuale janë 8.4 % në muaj (të paguajtura gjysë për gjysë nga punëdhënësi dhe punëtori). Në përqindjen e tillë nuk përfshihen edhe kuotizimet tjera, siç janë për shembull ata të sigurimit invalidor. Pagesa bëhet deri në moshën e pensionimit.

Se a dotë fitohet një rentë e plotë apo e pjesshme në moshën e pensionimit, e gjithë kjo dotë n'varet sidomos nga vitet e kuotizimit dhe nga të ardhurat e realizuara mbrenda gjithë viteve të pagesave. Për me fituar një rentë të plotë, personi që ka paguar kuotizimet e tija duhet që pagesat të jenë bërë pandërprerje që prej moshës 20 vjeçare deri në vitin e pensionimit. Por kjo nuk nënkupton aspak se personit në fjalë do t'i takojë një rentë e plotë maksimale. E gjithë kjo dotë n'varet pra edhe nga të ardhurat e realizuara mbrenda viteve të kuotizimit.

Të marrim një shembull: nësi dikushi ka kuotizuar pandërprerje, por të ardhurat e tija mesatare vjetore nuk i kanë tejkaluar 14'100 franga, atëherë atij do t'i takojë një rentë e plotë, por minimale, qoftë 1175 franga në muaj. Kurse për personin i cili ka kuotizuar pandërprerje dhe të ardhurat vjetore i tejkalojnë 84'600 në vitë, atëherë atij do t'i takojë renta e plotë me shumë prej 2350 franga në muaj. Kjo definitivisht nënkupton se renta maksimale mujore në Zvicër për një person është 2350 franga. Kurse për dy bashkëshortë është 3525 franga maksimum (d.m.th renta e tyre e përbashkët nuk duhet të tejkalojë 150% të rentës së një personi). Sipas statistikave, nuk është i madhë numri i atyre që marrin një rentë maksimale. Shumë reagime të bafasueshme ndodhin kur iu tregohet disave se çfarë rente mujore i pret! Për me e kuptuar më mirë situatën personale që na preokupon, ligji mundëson që personat e moshës mbi 40 vjeçare të kenë të drejtë të kërkojnë t'ju prezantohet një llojë bilanci për situatën e tyre (për vlerën e parashikueshme të rentës).

Shumat e sipërpërmendura flasin qartë se me të ardhurat e tilla ka me qenë sadopak vështirë që, në aspektin financiar, të çohet një jetë komode. Por, sistemi i sigurimeve pensionale në Zvicër, duke u mbështetur në rregullat e sigurimit të minimumit jetësor, për personat të cilët nuk arrijnë të sigurojnë jetën e tyre përmes të ardhurave nga rentat dhe nuk kanë asnjë burim tjetër financiar, atëherë shteti iu akordon edhe të ardhura të tjera shtesë të ashtuquajtura «plotësuese». Megjithatë, për me evituar një ngarkesë të lartë financiare në barrë të shtetit, janë vënë në dispozicion edhe dy forma tjera të kuotizimit (dy shtyllat të cekura mëposhtë) të cilat mundësojnë t'i mbulojmë «boshëllëqet» financiare në moshën e pensionimit.

#### **Shtylla e dytë: arka e pensionimit**

Pagimi i kuotizimeve sipas rregullave të arkës së pensionimit është e detyrueshme për të gjithë të punësuarit. Kuotizimet fillojnë që nga moshën 17 vjeçare poqese të ardhurat tejkalojnë shumën e caktuar në vitë. Ashtu si rregullat e shtyllës së parë, edhe kuotizimet në arkën e pensionimit tërhiqen drejtpërdrejt prej rrogës mujore. Si punëdhënësi ashtu edhe punëtori janë të detyruar të bëjnë pagesën e duhur (sipas rregullave të kontributit të përbashkët).

Renta e pleqësisë do të n'varet pastaj nga shuma e kuotizuar dhe nga rregullat që aplikohen nga arka e pensionimit ku bëhet pagesa. Shuma e grumbulluar deri në vitin e pensionimit do të shërbejë pastaj si bazë për caktimin e rentave mujore. Është e mundshme gjithashtu që shuma e tillë të merret, pjesërisht apo totalisht, në formë kapitali.

### **Shtylla e tretë: arka private e pensionimit**

Kuotizimet në arkën e tillë nuk janë aspak të detyrueshme. Është kjo një formë sigurimi plotësues, e cila, si zakonisht, gëzon kureshtjen e personave të interesuar, por edhe që posedojnë mjete financiare të mjaftueshme, që të sigurojnë njëllojë konfori financiar në moshën e pleqërisë. Kuotizimi përmes kësaj forme mund të bëhet përmes ndonjë institucioni bankar apo ndonjë sigurimi, që personi i interesuar e zgjedh lirisht.

Kontratat e lidhura për kuotizimet e tilla mundë të parashikojnë që të merren angazhime për pagesa të rregullta mujore apo vjetore (kjo ndodhë si zakonisht në rastet e imponimit nga institucionet financiare, për shembull në raste të blerjes së ndonjë banese apo shtëpie, edhe atë për me siguruar një formë amortizimi për objektin e blerë). Mundë të zgjidhet edhe opcioni me një fleksibilitet i cili mundëson të jemi të lirë në shumat që dëshirojmë t'i paguajmë. Këto dy forma natyrisht se i kanë të metat dhe përparësitë e tyre.

Kuotizimet përmes arkave private të pensionimit i kanë disa vlera të pamohueshme në aspektin tatimor; shuma e tërësishme e kuotizuar mbrenda një viti mundë të zbritet në deklaratat tona tatimore. Përmes një operacion të tillë, mundë të bëhet një ekonomizim i rëndësishëm, duke n'a mundësuar kështu që të paguajmë më pak tatime.

Në një artikull tjetër dotë jepen disa sqarime lidhur me mundësitë dhe kushtet e tërheqjes së shumave të depozuara në arkat e pensionimit. Kurse një temë tjetër dotë përqëndrohet në çështjen e pensionimit të parakohshëm dhe pasojat e tijë. E më vonë edhe tema e «problematikës» tejet specifike të sigurimit pensional dhe invalidor për shtetasit e Kosovës që e kanë lëshuar territorin zvicran.

Zyra për këshilla juridike « BEGZATI »  
Av. J. J. Rousseau 7, 2000 Neuchâtel  
E-mail : Lirim.Begzati@hotmail.com  
Kontakt : 079/354'67'13  
www.zyra-begzati.ch